PSH.nr. 1095/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "D & T GROYUP" SH.P.K – Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE: "PROFITECH"SH.P.K –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ambulanca për nevojat e shëndetësisë primare ne Komunën Prizrenit", me nr te prok: 622-20-4895-1-2-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Prizren, më datë: 11.01.2020 , mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "D & T GROYUP" SH.P.K – Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ambulanca për nevojat e shëndetësisë primare ne Komunën Prizrenit", me nr te prok: 622-20-4895-1-2-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Prizren.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie te kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me ambulanca për nevojat e shëndetësisë primare ne Komunën Prizrenit", me nr te prok: 622-20-4895-1-2-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Prizren dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "D & T GROYUP" SH.P.K – Gjakovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "D & T GROYUP" SH.P.K – Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 14.12.2020 me nr 1095/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me ambulanca për nevojat e shëndetësisë primare ne Komunën Prizrenit", me nr te prok: 622-20-4895-1-2-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 par. 1 dhe 3 , 6 par. 2, 7 par. 1 dhe 4, 51, 52 par. 4, 56, 59 par. 2 dhe 4, 60 par. 2, dhe nenin 72 par. 3 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional te prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 28.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin te Pika 1 e kësaj ankese, se AK nuk ka bere vlerësim te saktë te ofertës sipas kërkesave te dosjes se tenderit, ka bere lëshim te madh duke e rekomanduar për kontrate kompaninë PROFITECH sh.p.k e cila nuk i plotëson as kërkesat minimale te kërkuara ne dosjen e tenderit sipas kërkesave te FDT, pasi qe në te kaluarën kompania PROFITECH sh,p.k nuk ka bere asnjë furnizim me autoambulanca sipas kërkesës se dosjes së tenderit te FDT sepse kërkesa e AK Komuna e Prizrenit ne dosjen e tenderit konkretisht te FDT pika 9.1 & 9.2 është shume e qarte-ku thuhet: OE duhet te këtë se paku 150.000,00 euro kontrata te realizuara gjate

3 viteve te fundit, te **natyrës së kontratës**, kompania ne fjalë nuk ka here asnjë furnizim te natyrës se kontratës Furnizimin me Ambulanca, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet te prokurimit ka bere Rivlerësimin e ofertave duke u bazuar ne vendimin e Panelit Shqyrtues te OSHP-se nr.794-796/20. Sipas këtij vendimi është kërkuar qe bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se, AK te kërkoj informacion shtese lidhur me projektet e realizuar te natyrës se kontratës nga OE i rekomanduar për kontrate.

Komisioni i rivlerësimit te AK-se ka bere kërkesë për informacion shtese dhe me datën 01.12.2020 ka pranuar dokumentacionin shtese ne e-prokurim dhe ne e-mail zyrtar nga OE i rekomanduar për kontrate. Pas kontrollimit te dokumentacionit shtese te OE i rekomanduar për kontrate, komisioni vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate ka kontrata për furnizime me automjete, makineri, pajisje te ndryshme specialistike për Forcën e Sigurisë se Kosovës, ku për vitet 2018-2020 ka një qarkullim mbi 2 milion euro.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate e plotëson edhe kriterin e kërkuar me referenca për furnizime te natyrës se kontratës ne shumen mbi 150.000,00 €. Referencat e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate te cilat lidhen me furnizime me automjete, makineri e pajisje specialisitke për FSK sipas mendimit te ekspertit shqyrtues i përkasin te njëjtës natyre te kontratës për furnizim ne këtë aktivitet te prokurimit dhe si te tilla janë te pranueshme dhe e plotësojnë kërkesën e dosjes se tenderit. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues te Pika 2, se ne jemi eliminuar nga AK Komuna e Prizrenit për shkak se norma e TVSH për ambulanca duhet te aplikohet 8%, ne e bëjmë ne dijeni AK-në, se ne jemi **vet modifikues të ambulancave** ne një investim te përbashkët me kompaninë Auto shtëpia SIQAN1 dhe e kemi për obligim qe ta aplikojmë normën e TVSH 18%, AK është thirrur ne ligjin mbi TVSH-ne në të cilën norme **8% duhet ta aplikojnë importet e autoambulancave**, kurse ne **nuk bëjmë importe te autoambulancave por bëjmë importe te automjeteve komerciale dhe ato modifikojmë ne Kosove ne autoambulance** dhe për këtë e kemi obligim qe ti paguajmë 18% normën e TVSH-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Komisioni i rivlerësimit te AK-se, po ashtu duke u bazuar ne vendimin e panelit shqyrtues nr.794-796/20 lidhur me pikat kontestuese për normën e TVSH-se, 8% apo 18% është rekomanduar qe gjate rivlerësimit AK-ja të beje kalkulimin dhe vërtetoj saktë nëse ka gabime aritmetikore mbi 2% te vlerës totale te ofertës.

Mbi këtë baze AK ka analizuar dhe ka vlerësuar duke u bazuar ne nenin 26 pika 2.13 te ligjit nr.05/L-037 për TVSH, thuhet qe norma e reduktuar e TVSH-se llogaritet dhe paguhet prej **8%** për furnizime me **Autoambulancat**, pajisjet mjekësore etj. Kurse OE ankues normën e TVSH-se ne tabelën e përshkrimit te çmimeve e ka dhënë prej **18%**. Kjo vlere e TVSH është ne kundërshtim me ligjin e TVSH që ka të bëjë me importim, furnizim me autoambulanca. Po ashtu me këtë vlere te TVSH, oferta e OE ankuese me gabime aritmetikore tejkalon me shume se **± 2% vlerën totale te ofertës**.
Ky tejkalim është ne kundërshtim me piken 3 te nenit 59 te LPP-se dhe si te tille e bene ofertën e pa përgjegjshme. Pohimi i OE ankues se kompania e tyre **autoambulancën e vet modifikon** ne bashkëpunim me një kompani tjetër vendore, e rëndon edhe me tepër situatën, sepse AK nuk pranon modifikime por autoambulanca duhet te vije **origjinal nga prodhuesi**. Kështu është kërkuar edhe ne dosjen e tenderit qe katalogu për automjetin te jete nga prodhuesi e jo modifikim vendor.

Ne anën tjetër OE i rekomanduar për kontrate, ka ofruar autoambulancën e kompletuar nga **prodhuesi** me destinim përkatës **si produkt final**. Mbi këtë baze eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të **pa bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES: Autoriteti kontraktues ka zbatuar vendimin e panelit shqyrtues nr.794-796/20 dhe ka bere rivlerësimin e ofertave. Ka eliminuar ofertën OE ankues si tenderues i pa përgjegjshëm për shkak se ka ofruar normën e TVSH ne listën e çmimeve ne vlere prej 18% qe është ne kundërshtim me ligjin e TVSH ne Kosove. Norma prej 18% e llogaritur nga OE ankues e tejkalon gabimin aritmetikore me shume se 2% te vlerës totale te ofertës e cila nuk lejohet me nenin 59 te LPP-se.
Është rekomanduar për kontrate OE i përgjegjshëm me çmim me te ulet. Gjatë procesit te ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se. Po ashtu është respektuar edhe neni 60 i LPP-se kriteri për dhënie te kontratës. Vlen te theksohet se oferta e rekomanduar për kontrate ka çmimin me te ulet për mbi 1300 € se oferta e OE ankues.. Nuk ka shkelje te neneve te LPP-se te përmendura ne ankesën e operatorit ekonomik ankues.

Nga ajo qe e sqaruam me lartë ne përgjigjet e pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të **refuzohet** si e pa bazuara.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **Vazhdoj** me dhënie te kontratës për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit**, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 28.12.2020 ka njoftuar OSHP-në se **PAJTOHET** plotësisht me raportin e ekspertit shqyrtues .

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 29.12.2020 ka njoftuar OSHP-në se **NUK PAJTOHET** me raportin e ekspertit shqyrtues .

Ne e konfirmojmë pranimin e mendimit te ekspertit dhe me te njëjtin mendim **NUK PAJTOHEMI** pre arsyet si më poshtë.

Pretendimi nr. 1 Eksperti nuk ka dhen mendim te saktë pasi qe kërkesa e AK Komuna e Prizrenit ne dosjen e tenderit është shumë e qarte OE duhet te ketë kontrata te realizuara "Referenca te natyrës se Kontratës" ne vlere 150.000,00 Euro, e natyra e kontratës është " Furnizim me ambulance pre nevojat e shëndetësisë primare ne Komunën e Prizrenit" kurse OE I rekomanduar për kontrate nuk ka realizuar asnjë kontrate ne te kaluarën për furnizim me autoambulanca me çka dëshmojini edhe sqarimet e kërkuara ne Rivlerësim nga AK, por është shqetësuese fakti se AK prap e ka rekomanduar për kontrate një kompani e cila nuk I plotëson kërkesat e dosjes se tenderit sepse furnizim me autoambulanca nuk është thjesht makineri siç thotë eksperti ne mendimin e tije, por ka te bej me pajisje mjekësorë për te cilat OE duhet te ketë eksperience ne, instalimin e tyre, trajnimin e stafit mjekësorë për përdorimin e tyre pasi duhet te kemi parasysh se çdo jo profesionalizëm ne përdorimin-trajnimin e tyre mund te kushtoj me humbje te ndonjë jete tek pacienti, prandaj eksperti I ka tejkaluar kërkesat e dosjes se tenderit dhe ka jap mendim jo te saktë se kinse referenca për furnizime me automjete motorike konsiderohen te njëjta me ato shëndetësorë te cilat janë kërkuar ne dosjen e tenderit prandaj ky mendim I ekspertit nuk qëndron I bazuar.

Pretendimi nr. 2 I ekspertit nuk qëndron pasi qe ne, ne çdo shitje te autoambulancave te cilat I bëjmë ne Kosove I faturojmë me normën e TVSH-se 18%, pasi qe ne e kemi kompaninë profesionale ne Kosove e cila bën modifikimin e autoambulancave, te cilat ATESTOHEN dhe pasi ta kalojnë testin te njëjtat plasohen ne tregun vendor dhe atë jashtë saj, prandaj po ju bashkëngjisim disa nga faturat tona dhe DUD doganor ku dëshmon se ne aplikojmë normën 18% te TVSh-së dhe e njëjta nuk është aplikim i gabuar ne ofertën tone, për me tepër AK nuk ka kërkuar ne përshkrimin e çmimeve qe TVSH-ja me qen 8% ose 18% ku e ka len te hapur qe secili OE ta plotëson vlerën e TVSH-se ne mënyrën e tije.

Eksperti ne mendimin e tije e plotëson edhe me tepër bindjen tone se nuk ka dhen asnjërin nga mendimet e tije te sakta sipas pretendimeve tona te ankesës dhe sipas kërkesave te dosjes se tenderit, dhe nuk është lëshuar fare ne kërkesat e dosjes se tenderit sepse sa për informim te tije, kompania jone merret qe shumë vite me furnizim te Autoambulancave, dhe qe disa vite se bashku me partnerin tone dhe me një staf profesional I cili është ardhur nga shtetet e BE-se dhe me një teknologji te avancuar ku bëjmë modifikimin e tyre dhe jemi

kompania e vetme ne Ballkan e cila furnizojmë me Autoambulanca për Bashkimin Evropian me çka dëshmojnë edhe referencat e ngarkuar ne dosjen e tenderit, ku tash se fundi kemi marr edhe një kontrate tjetër për eksportin e autoambulancave jashtë vendit, sa për sqarim asnjë prodhues I Automjeteve ne bote nuk prodhon Autoambulanca por prodhon automjete dhe janë kompanitë profesionale te cilat I modifikojnë ato ne autoambulanca dhe te njëjtat I atestojne te tilla dhe pastaj dalin ne tregun vendor dhe atë te jashtëm.

Shqetësuese është se eksperti ka jap mendim te një anshëm dhe nuk e ka analizuar fare as dokumentin e OE te rekomanduar për kontrate , pasi qe ka jap mendim se kinse automjeti duhet te vije origjinal nga prodhuesi si Autoambulance, kurse OE I rekomanduar për kontrate e ka ofruar katalogun e modifikuesit TIMAK Albania, dhe për ekspertin "TIMAK Albania është prodhues I automjeteve" kurse ne nuk jemi prodhues me çka forcon edhe me tepër bindjen se nuk është dhen mendim I sakt I ekspertit ne asnjërën nga pretendimet ton atë ankesës.

Për fund mendimi I ekspertit nuk qëndron ne asnjërin nga mendimet e tije pasi qe nuk është bere ekspertiza ne baze te kërkesave te dosjes se tenderit dhe e njëjta është bere ne mënyrë sipërfaqësore dhe konsiderojmë se kompania jone jemi kompania e përgjegjshme me çmimin me te ulet ne ketë projekt.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku nga AK është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE: "PROFITECH"SH.P.K –Prishtinë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se AK nuk ka bere vlerësim te saktë te ofertës sipas kërkesave te dosjes së tenderit, ka bere lëshim te madh duke e rekomanduar për kontrate kompaninë PROFITECH sh.p.k e cila nuk i plotëson as kërkesat minimale te kërkuara ne dosjen e tenderit sipas kërkesave te FDT, pasi qe në te kaluarën kompania PROFITECH sh,p.k nuk ka bere asnjë furnizim me autoambulanca sipas kërkesës se dosjes së tenderit te FDT sepse kërkesa e AK Komuna e Prizrenit ne dosjen e tenderit konkretisht te FDT pika 9.1 & 9.2 është shume e qarte-ku thuhet: OE duhet te këtë se paku 150.000,00 euro kontrata te realizuara gjate 3 viteve

te fundit, te **natyrës së kontratës**, kompania ne fjalë nuk ka here asnjë furnizim te natyrës se kontratës Furnizimin me Ambulanca, Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues për këtë aktivitet te prokurimit ka bere Rivlerësimin e ofertave duke u bazuar në vendimin e Panelit Shqyrtues te OSHP-se nr.794-796/20. Sipas këtij vendimi është kërkuar qe bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se, AK te kërkoj informacion shtese lidhur me projektet e realizuar te natyrës se kontratës nga OE i rekomanduar për kontrate.

Komisioni i rivlerësimit te AK-se ka bere kërkesë për informacion shtese dhe me datën 01.12.2020 ka pranuar dokumentacionin shtese ne e-prokurim dhe ne e-mail zyrtar nga OE i rekomanduar për kontrate. Pas kontrollimit te dokumentacionit shtese te OE i rekomanduar për kontrate, komisioni vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate ka kontrata për furnizime me automjete, makineri, pajisje te ndryshme specialistike për Forcën e Sigurisë se Kosovës, ku për vitet 2018-2020 ka një qarkullim mbi 2 milion euro.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate e plotëson edhe kriterin e kërkuar me referenca për furnizime te natyrës se kontratës ne shumen mbi 150.000,00 €. Referencat e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate te cilat lidhen me furnizime me automjete, makineri e pajisje specialisitke për FSK, ku këto kontratat dhe referenca i përkasin te njëjtës natyre te kontratës për furnizim ne këtë aktivitet te prokurimit dhe si te tilla janë te pranueshme dhe e plotësojnë kërkesën e dosjes se tenderit. Prandaj vlerësojmë si pretendim ankimor të **pa bazuar**.

Lidhur me pretendimin ankuesit , se ne jemi eliminuar nga AK Komuna e Prizrenit për shkak se norma e TVSH për ambulanca duhet te aplikohet 8%, ne e bëjmë ne dijeni AK-në, se ne jemi **vet modifikues të ambulancave** ne një investim te përbashkët me kompaninë Auto shtëpia SIQAN1 dhe e kemi për obligim qe ta aplikojmë normën e TVSH 18%, AK është thirrur ne ligjin mbi TVSH-ne në të cilën norme **8% duhet ta aplikojnë importet e autoambulancave**, kurse ne **nuk bëjmë importe te autoambulancave por bëjmë importe te automjeteve komerciale dhe ato modifikojmë ne Kosove ne autoambulance** dhe për këtë e kemi obligim qe ti paguajmë 18% normën e TVSH-së.

Paneli shqyrtues sqaron se për normën e TVSH-së, KRPP-ja ka dhen sqarim tek pyetja 46 duke cituar:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo

atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne procesverbalin e hapjes dhe në Vendimin e AK-së- Njoftimin për dhënie te kontratës te datës 03.12.2020, ka parë se OE ankues ka ofertuar me çmim prej 89999,98€, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofertuar me çmim prej 88610,00€.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK duhet te kërkoj sqarim nga autoriteti kompetente (Dogana, ATK etj) për te vërtetuar, se sa është norma e TVSH –së, për autoambulancat e kërkuar sipas dosjes se tenderit për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe te bej kalkulimin e çmimit duke aplikuar normën e TVSH-se, qe është e saktë për produktet në fjalë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit pasi te vërtetoj normën e TVSH-se , duhet ti referohet interpretimit te KRPP-së, te dhen si me lart ku thuhet se në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit duhet ta analizoj pohimi i OE ankues se kompania e tyre **autoambulancën e vet modifikon** ne bashkëpunim me një kompani tjetër vendore, në ketë pike AK duhet te pranoj vetëm ato produkte ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit, në baze te kërkesave dhe specifikave te kërkuara ne DT-të. Te vërtetohet nga AK se a mund te pranohen modifikime për autoambulanca apo ato duhet te vije **origjinal nga prodhuesi**. Ku AK në dosjen e tenderit ka kërkuar që katalogu për automjetin te jete nga prodhuesi.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontrate, ka ofruar autoambulancën e kompletuar nga **prodhuesi** me destinim përkatës **si produkt final**.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për OE te rekomanduar për dhënie te kontratës dhe se është vërtetuar se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës plotëson kërkesën e AK-së, sa i përket referencave.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "KK Prizren"

1x1 OE- "D & T GROUP"shpk -Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.